



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dokument Parlamentar)

Tiranë, më 9. 11.2022

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“ PËR BUXHETIN E VITIT 2022”

- Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në disa seanca të mbledhjeve të tij të datave 02,03,05,08 nëntor 2021, mori në shqyrtim në parim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave.

Relatorë të projektligjit janë: znj. Lindita Buxheli, znj. Flutura Aça, z. Ilir Topi, z. Luçiano Boçi.

Në diskutimin në parim të projektligjit ishin të pranishme dhe dhanë shpjegime rreth tij Znj. Evis Kushi, Ministre e Arsimit dhe Sportit; znj. Elva Margariti, Ministre e Kulturës; përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe ekspertë të ministrive përkatëse. Gjithashtu, u organizuan seanca dëgjimore me institucione që financohen edhe nga Buxheti i Shtetit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Sipas relacionit shoqërues, që në fillim theksohet se Projektbuxheti 2022 synon rimëkëmbjen ekonomike të vendit, përmes skemave të punësimit, mbështetjes proaktive ndaj biznesit, rindërtimit të plotë të banesave të qytetarëve të prekur nga tërmeti, si dhe marrjen e masave parandaluese të përhapjes së mëtejshme të COVID-19.

Në projektbuxhetin e vitit 2022, **programimi i të ardhurave buxhetore** mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskalë, në ligjin organik të buxhetit, politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal në periudhën afatmesme dhe afatgjatë etj..

Buxheti i MAS 2020

Buxheti për arsimin dhe sportin vazhdon trendin rritës si në vlera nominale, ashtu dhe në përqindje ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2022, me synimin të përmbushë objektivat dhe angazhimet e Qeverisë, por duke reflektuar padyshim edhe të gjitha masat e marra për kapërcimin e pasojave të tërmetit të 26 nëtorit dhe situatës së pandemisë Covid-19.

Fondet për sektorin e arsimit në vitin 2022 janë 65.6 miliardë lekë. Fondet përfaqësojnë 10.2% ndaj shpenzimeve të buxhetit apo 3.51 % ndaj produktit të brendshëm bruto.

Fondet buxhetore për MAS për vitin 2022 janë planifikuar 45 miliardë e 658 milionë lekë, që në krahasim me fondet e rishikuara të vitit 2021 kanë një rritje prej 2 miliardë e 676 milionë lekë, ose 6.2%.

Buxhetit të MAS për vitin 2022 do t'i shtohet edhe shtesa e pagave prej 6% për të gjithë punonjësit mësimorë dhe punonjësit psikosocialë.

Arsimi parauniversitar:

Fondet totale për arsimin parauniversitar janë 51.2 miliardë lekë.

Krahasuar me buxhetin e rishikuar 2021, buxheti për arsimin parauniversitar ka një rritje në vlerë nominale me 1 miliard e 912 milion lekë ose 6,2% krahasuar me vitin 2021, ku shpenzimet kapitale janë rritur 1,2 miliardë lekë dhe shpenzimet korente 691 milion leke.

Prioriteti kryesor i Qeverisë Shqiptare për arsimin parauniversitar me buxhetin 2022, do të jetë sigurimi i cilësisë së reformave dhe gjithëpërfshirja, përmes:

- a) Rritjes së numrit të fëmijëve që ndjekin arsimin parashkollor, si dhe përfshirjes së klasës përgatitore në arsimin e detyrueshëm dhe reduktimit të numrit të klasave kolektive;
- b) Sigurimin e **shërbimit të transportit** dhe mbulimin e shpenzimeve të transportit për rreth **32-35 mijë nxënës** që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla dhe transportin për **rreth 12 mijë mësues** që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës; Buxheti i vitit 2022 planifikon rreth **950 milion lekë** dhe duke filluar nga janari 2022, çmimi i biletës për transportin e nxënësve do të rritet 50% krahasuar me çmimin aktual.
- c) **Ofrimin e teksteve shkollore në përdorim falas, për rreth 280 mijë nxënës** që ndjekin arsimin bazë (klasa e parë deri në klasën e nëntë) dhe të **18-20 mijë nxënësve të arsimit të mesëm të lartë** nga shtresat sociale në nevojë, në shumën prej **1,1 miliardë lekë/vit.**

- d) **Përfshirjen e gjuhës së huaj (gjuhës angleze)** që në klasën e parë të arsimit fillor dhe nga klasa e tretë dy gjuhë të huaja, nga të cilat gjuha angleze dhe një gjuhë tjetër e huaj është me zgjedhje;
- e) **Dhënia e bursave financiare** apo kuotës ushqimore/financiare për **nxënës me nevoja të veçanta**, si dhe **fëmijëve me ndikim në uljen e braktisjes shkollore**, të nxënësve të arsimit parauniversitar, nga shtresat sociale në nevojë, **me 90-110 milion lekë**; deri në vitin 2022, çdo fëmijë rom dhe egjiptian do të regjistrohet në shkollë, 100% e tyre do të mbarojnë arsimin e detyruar dhe 70% më shumë vajza e djem romë dhe egjiptianë do të përfundojnë arsimin e mesëm të lartë;
- f) Mbështetje për **nxënës me nevoja të veçanta janë planifikuar 100-110 milionë lekë në vit** (Instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë, Instituti i Nxënësve që nuk shikojnë, Shkolla Luigj Gurakuqi, etj. dhe shkollat special).
- g) **Rritjen e numrit të punonjësve të shërbimit psiko-social** në sistemin e arsimit parauniversitar, brenda numrit të miratuar të punonjësve arsimorë për vitin 2022;
- h) **Zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës** bazuar në standarde të krahasueshme me vendet e BE-së, nëpërmjet zbatimit të kurrikulës së re në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar, si dhe e përgatitjes së teksteve specifike për nxënësit e pakicave kombëtare; shpenzimet për **rishikimin e kurrikulës dhe hartimin e programeve të arsimit parauniversitar për veprimtarinë e ASCAP janë planifikuar 70-90 milion lekë në vit.**
- i) **Fuqizimin e TIK-ut në arsim**, nëpërmjet hartimit të një platforme dhe plani kombëtar veprimi për zbatimin e TIK-ut në Arsim, si dhe krijimit të një infrastrukture të qëndrueshme, gjerësisht të përdorshme të burimeve digjitale në shkolla; në buxhetin 2022 janë planifikuar **investime kapitale për blerje pajisje kompjuterike dhe fuqizimin e TIK-ut në arsim në shumën 570 milion lekë** (200 milionë janë bashkëfinancim me UNDP) dhe do të furnizohen me përparësi me pajisje kompjuterike (kompjuterat, fotokopje) shkollat të cilat aplikohet sistemi SMIP dhe përlogariten të furnizohen rreth **200 institucione arsimore.**
- j) **Shtimi i klasave të profilizuara sportive** në mënyrë progresive në të gjithë vendin. Duke filluar nga viti shkollor 2021-2022, do të shtohen rreth 200 klasa sportive (nga 223 në 423), duke shtuar edhe disiplina të reja sportive, si gjimnastikë, atletikë dhe tenis.
- k) **Realizimin e maturës shtetërore 2022-2024**, sipas kurrikulës së re me bazë kompetencën, ku janë planifikuar të shpenzohen 20 milion lek/vit;
- l) Realizimi i testimit "Mësues për Shqipërinë" në formë elektronike dhe **trajnimin çdo vit të 10-15% të punonjësve mësimorë** të arsimit parauniversitar, ku janë planifikuar 80-100 milion lekë në vit.
- m) Përmirësimi i rezultateve në provimet e maturës shtetërore, duke rritura notën mesatare nga 7.17 aktualisht në 7.6 në vitin 2022-2024; do të realizohen **testet kombëtare në klasën e pestë dhe klasën e nëntë**, si dhe teste kombëtare e ndërkombëtare të PIZA, etj., me 5-10 milionë lekë në vit;
- n) **Përmirësimin e infrastrukturës shkollore**, përmes investimit në shkolla; për vitin 2022 janë planifikuar **1,2 miliard lekë** investime kapitale dhe do të bashkëfinancohen projektet e paraqitura nga NJQV-të, me financim në dy vite

buxhetore (2022-2023), ku parashikohen të financohen afro **20 objekte arsimore**, me rreth 400 klasa dhe laboratorë mësimore, ku përfitojnë afro 8,000- 10,000 nxënës dhe 900-1,100 mësues dhe edukatorë (këtu përfshihen edhe shkollat, të cilat janë duke u ndërtuar në partneritet publik privat me bashkinë Tiranë, 5 (pesë) prej të cilëve përfundojnë në fund të vitit 2021, 4 (katër) të tjera janë në ndërtim dhe përfundojnë në shtator 2022 dhe 8 të tjera janë në proces), si dhe shkollat që po rindërtohen nga programi i Rindërtimit.

- o) **Pasurimi i fondit të bibliotekave të shkollave 9-vjeçare** dhe atyre të mesme me literaturë shkencore dhe artistike, për rritjen e mundësisë, aksesit të fëmijëve e sidomos të fëmijëve nga shtresat sociale në nevojë. Për vitin 2022 janë planifikuar të financohen 20 milionë lekë.

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

Buxheti i planifikuar për Programin e Arsimit të mesëm profesional, për vitin 2022 është 3 miliardë e 63 milionë lekë.

Politika e këtij programi synon të përmbushë qëllimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 dhe planit të saj të veprimit, të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin, arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës

Programi synon zhvillimin e një sistemi të arsimit dhe formimit profesional, i cili garanton arsim dhe formim profesional cilësor dhe gjithëpërfshirës nëpërmjet:

- Sigurimit të një procesi mësimor cilësor e me kushte optimale të të nxënësve, teorik e praktik, për t'i pajisur nxënësit me kompetencat e duhura;
- Ndërtimit, rikostruksionit dhe paisjes me laboratorë/makineri, të shkollave dhe reparteve të praktikave profesionale si një nga prioritetet dhe në programin e qeverisë Shqipëria 2030 për arsimin profesional;
- Rishikimit të programeve ekzistuese dhe hartimit të programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe të gjithëpërfshirjes, në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
- Hartimit dhe miratimit të standardeve të profesioneve dhe kualifikimeve sipas niveleve të KSHK;
- Zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve, si një nga shtyllat kryesore të sigurimit të cilësisë në arsimin profesional;
- Fillimit të implementimit të akreditimit të ofruesve të AFP-së;
- Funksionimit të komitetit sektorial të TIK;
- Ngritjes dhe funksionimit të strukturës së Inspektimit të Arsimit Profesional;
- Modernizimit të kuadrit ligjor të AFP ekzistues, që rregullojnë sistemin e AFP-së, si dhe aspektet që kanë të bëjnë me AFP-në (hartimi i skeletkurrikulave, materialeve mësimore, trajnimi i mësuesve, etj.) në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Treguesit e Performancës për Buxhetin 2022

- Rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2022, krahasuar me 42% në vitin 2020;

- Rritja e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 43% e totalit në vitin 2020 në 55% e totalit në vitin 2022;
- Rritja e numrit të nxënësve që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, në 19.5% të totalit të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar në vitin 2022, krahasur me 17 % në vitin 2020.

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor

Për vitin 2022, buxheti i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (pa përfshirë fondet jashtëbuxhetore) është planifikuar në një vlerë totale prej 11 miliardë e 752 milionë lekësh.

Buxheti 2022 i MASR për programin buxhetor “**Arsimi i Lartë**” ka shënuar një **rritje prej 9% ose 910 milion lekë** më shumë sesa buxheti 2021, rritje që do të fokusohet për projektet e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë dhe projekte të përbashkëta të IAL-ve publike.

Gjithashtu, edhe buxheti i vitit 2021 i MAS për programin buxhetor “**Kërkimi Shkencor**” ka një **rritje me 9% ose 66 milionë lekë** më shumë krahasuar me vitin 2021.

Prioritet e Qeverisë për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, synojnë:

Hartimin e një plani për zhvillimin e sistemit arsimor, për të pajisur studentët shqiptarë me dije dhe aftësi të konkureshme me bashkëmoshatarët e tyre në BE. Shkollat profesionale dhe universitetet do të përgatisin qytetarin e mirë dhe punonjësin e suksesshëm të vitit 2030-të. Kjo do të arrihet përmes:

- 1) Investimeve në laboratorë për kërkimin shkencor** (programi i kërkimit shkencor) dhe sigurimin e integritet akademik dhe shkencor të universiteteve, me qëllim përmirësimin e cilësisë së produktit universitar, ndërsa diploma e secilit student do të mbartë vlerën që duhet të ketë. Për **projektet e infrastrukturës së kërkimit shkencor**/shpenzime kapitale, pjesë e grandit për kërkimin shkencor, janë planifikuar në total **250 milionë lekë** ose 50 milionë lekë më shumë se viti 2021 dhe 16 milionë lekë më shumë për projektet kërkimore-shkencore të IAL-ve dhe programeve kombëtare të zhvillimit dhe projektet bilaterale. Këto fonde shpërndahen nga AKSHI. Po ashtu janë planifikuar edhe 100 milionë lekë financim i huaj, për bashkëfinancimin e 50-70 projekteve të IAL-ve publike me donatorët.
- 2) Investimeve infrastrukturore në kampuset universitare (pjesë e programit të arsimit të lartë)** me qëllim që të përmirësohet eksperiencia studentore dhe të inkurajohen të rinjtë të ndjekin ëndrrat e tyre në kampuset universitare shqiptare. Edhe gjatë periudhës 2022-2024, do të vijojnë investimet e nisura nga vitit 2021 në infrastrukturën e kampuseve universitare, duke financuar me prioritet:
 - Projektin për rindërtimin e godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë në Universitetin Bujqësor- **56 milion lekë** (vazhdim 2021-2022);
 - Projektin për **Kampusin e Universitetit të Tiranës**, Universitetit të Arteve, të Akademisë së Policisë- **500 milion lekë** (VKM Nr. 641, date 29.7.2020)-fondet trashëgohe nga viti 2021;

- Projektin për ndërtimin e godinës së shëndetit publik në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë në shumën **142 milionë lekë**;
 - Projektin për rindërtimin e godinës së fakultetit të inxhinierisë së ndërtimit, **Universiteti Politeknik i Tiranës- 192 milionë lekë** (vazhdim 2021-2022);
 - Projekte të reja me përfitues IAL-të publike, në shumën **600 milionë lekë, në varësi me aplikimet e IAL –ve publike**;
 - TVSH për bashkëfinancim në projekte të huaja 56 milion lekë;
 - Financim i huaj - 200 milionë lekë dhe financohen rreth 40-50 projekte të IAL-ve publike me donatorë.
- 3) **Akreditimi institucional i 100% të IAL-ve dhe i programeve të studimit brenda afatit për akreditim.** Ndërtimi i instrumenteve të llogaridhënies publike të universiteteve dhe transparencës në linjë me rritjen e autonomisë, për vitin 2022 janë parashikuar fonde grand në shumën 15 milionë lekë.
- 4) **Ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë - fillon puna për hapjen e filialeve të Universiteteve më të mira ndërkombëtare në Shqipëri,** si dhe për programe studimi të përbashkëta dhe të dyfishta me to. MAS do të mbështesë hapjen e programeve në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare (Plani i Qeverisë 2021-2025 _Objektivat për arsimin) dhe për vitin 2022 është parashikuar një fond grand prej **800 milionë lekë.**
- 5) **“Granti për mësimdhënie për vitin 2022** (pa përfshirë bursat financiare dhe fondet grand për uljen e tarifës së akomodimit të studentëve) është planifikuar në masën **9.8 miliardë në vitin 2022** me një rritje mesatare 7.6% ndaj vitit paraardhës. Ky grand shpërndahet me vendim të organeve kolegjiale të IAL-ve publike. Pjesë e fondit “granti për mësimdhënie”, janë dhe fondet për të mbuluar uljen e tarifës së akomodimit të shpenzimeve për studentët që akomodohen në **“Shoqëritë e Trajtimit të studentëve”** në Tiranë dhe në rrethe, ku parashikohet të akomodohen rreth 6-8 mijë studentë, me një fond prej **250-300 milionë lekë për çdo vit.**
- 6) **“Grandi i mbështetjes studentore”** për vitin 2022, është planifikuar 900_1 miliardë lekë, ku përfitues parashikohet të jenë 11,500-12,000 **studentë, nga shtresat sociale në nevojë, si dhe studentë ekselencë** në IAL publike, të cilët përfitojnë bursa.
- 7) **Granti i punës kërkimore-shkencore** dhe veprimtarive krijuese është planifikuar **746 milionë lekë** dhe përveç infrastrukturës kërkimore-shkencore sa më sipër, do të mbështeten edhe aktivitetet sa më poshtë;
- a) *Financimi i Programeve Kombëtare/Ndërkombëtare të Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik të mbështetura financiarisht.* Nxitja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3,500 kërkuesve, ku prioritet kanë femrat në përputhje me parimet e barazisë gjinore, si dhe mbështetje financiare për kërkim fundamental në IAL publike. Për vitin 2022 janë parashikuar **69,4 milion lekë**, fonde grant të cilat shpërndahen me vendim BA te AKKSHI.
 - b) *Projekte bashkëpunimi të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare.* Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, nëpërmjet organizimit të seminareve dhe takimeve informuese në IAL mbi Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Në

vitin 2022 fondet kanë një rritje me 10-15% më shumë ndaj viti paraardhës, **me 46 milionë lekë në vit**, këto fonde grant shpërndahen me vendim BA të AKKSHI.

- c) Fondet për mbulimin e bursave financiare për **“studentët e ekselencës”**, që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitetet më të mira të botës; **janë parashikuar 200 milionë lekë në vit**. Me këtë fond mbështeten rreth 35-40 bursa ekselence në vit, duke e çuar numrin e studentëve të mbështetur financiarisht nga fillimi i këtij programi në rreth 380 studentë.
- d) Pjesëmarrja në programin **Horizon Europe, me 160 milion lekë/vit** (pagesë kuote anëtarësimi), dhe pagesa për vitin 2021-2022 do të realizohet nga fondet gjendje që trashëgohen, të rimbursuara nga BE në kuadër të programit Horizon 2020.
- e) Fonde grand për pjesëmarrje me të drejta të plotë të Republikës së Shqipërisë në programin **Erasmus+**, programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin, propozuar nga Komisioni Europian, që synon të nxisë modernizimin e sistemeve arsimore 20 milionë lekë në vit.
- f) Fonde “Për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e shkëmbimit akademik **“Fullbright”**”, në shumën **18-20 milionë lekë në vit**.

Programi për sportin

Për vitin 2022, buxheti për Sportin është planifikuar në total **413,7 milion lekë**, nga të cilat:

- **28,9 milionë lekë** janë shpenzime personeli për agjensinë e sportit,
 - **94,7 milionë lekë** janë shpenzime korrente/operative (602-606),
 - **272 milionë lekë** janë shpenzime kapitale (230+231) **Prioritetet e Qeverisë Shqiptare për Sportin synojnë:**
- a) Sigurimi i mbështetjes financiare për **federatat Olimpikë në aktivitete** Europiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Pekin 2022, si dhe Paris 2024, realizimi i 30-35 analizave anti-doping për sportiestët elitare, si dhe ato kandidatë për Lojërat Olimpikë **me rreth 60 milionë lekë**.
 - b) Mbështetja financiare për **Ekipin Kombëtar Olimpik** pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikë Japoni 2021, si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane, si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore 15 milion lekë.
 - c) Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, **trajnime çdo vit për 20-25%** e stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trajnerë, specialistë, instruktorë, mjekë, etj., ku përparësi kanë sportiestët dhe trajnerët femra) 1 milion lekë;
 - d) Mbështetje financiare për **shpërblimin e sportiestëve elitare**, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 20-25 sportistë elitare në vit, si dhe

mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese ne institucionet arsimore te arsimit parauniversitar dhe universitar 15 milion lekë.

- e) Mbështetje financiare, për veprimtarinë e **Agjencinë e Sportit** “Sigurimi i mbështetjes financiare për organizimin e aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare”, me 33 milion lekë në vit.
- f) Mbështetje financiare **me investime në sport**, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare, ku për vitin 2022 janë parashikuar në **270 milion lekë**.
- g) Financim i huaj për projekte në sport projekti “Be Active +” projekte të tjera në sport dhe projekte rinore, **me 20 milion lekë**. Sigurimi i mbështetjes financiare te aktiviteteve sportive promocionale me shkollat e arsimit parauniversitar dhe te IAL ne kuadër te nismës se Komisionit Evropian BE-Activ (si rishikim politikash, si dhe realizimi i 50 analizave nga 30 analiza që janë kryer deri tani, kundër dopingut në sport.)

Buxheti për Ministrinë e Kulturës

Ministria Kulturës, procesin e hartimit të PBA-së 2022 e ka vlerësuar si një moment të rëndësishëm në mbështetje të objektivave të Programit të Qeverisë, duke respektuar gjithashtu tavanet përfundimtare për vitet 2022-2024, me qëllim zhvillimin e Art-Kulturës si dhe Trashëgimisë Kulturore & Muzetë.

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të Udhëzimit nr.19 datë 09.07.2021 “*Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024*”, Ministria e Kulturës ka përgatitur kërkesat buxhetore në përputhje me tavanet e miratuara me VKM nr.440 datë 22.07.2021 për “*Miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor Afatmesëm 2022-2024*”, për tre programet buxhetore konkretisht:

1. Planifikim, Menaxhim, Administrim,
2. Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë,
3. Arti dhe Kultura.

Nisur nga treguesit , projektbuxheti i vitit 2022 krahasuar me buxhetin e vitit 2021 ka një rritje prej 46.6% ose 1.3 miliard lekë, kjo si rezultat i rritjes së shpenzimeve korrente dhe kapitale.

-Shpenzimet në Programin e Trashëgimisë Kulturore krahasuar me vitin 2021 janë rritur 179.5% ose 100 milionë lekë, fonde të cilat janë parashikuar të përdoren për mbulimin e ***gjithë aktiviteteve në fushën e trashëgimisë materiale dhe jomateriale, si dhe mbështetje financiare për programin e ri*** “Fondi kombëtar i kujdesit të trashëgimisë kulturore materiale (bonusi i rijetëzimit) nëpërmjet të cilit zbatohen politikat e programit qeverisës, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare për reformën ligjore në trashëgiminë kulturore, e cila nisi me miratimin e ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

“Bonusi i Rijetëzimit” është një financim për restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve në qendra historike, në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura dhe punësim për komunitetin.

-Shpenzimet në Programin e Artit dhe të Kulturës, krahasuar me vitin 2021 janë rritur 349.7% ose 350 milionë leke. Me këtë zë shpenzimesh janë parashikuar të realizohen kryesisht një rrjet aktivitetesh, që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e Artit Shqiptar në arenën ndërkombëtare, si dhe mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vëndin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës librit dhe përkthimit. Institucionet e vartësisë së këtij programi do të realizojnë një sërë veprimtarish artistike kulturore, do të realizojnë premiera si dhe rivënie. Në realizimin e veprimtarive të ndryshme artistike do të jetë prioritet integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe. Në këtë program, gjithashtu, është parashikuar edhe mbështetje për **Javët kulturore të huaja në Shqipëri** si një nga programet me te reja te Ministrisë se Kulturës, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga programi i Qeverisë Shqiptare, projekt do të zbatohet në kuadër të Politikave Integruese nëpërmjet artit-kulturës dhe trashëgimisë kulturore në RSH.

Planifikimi Shpenzimeve Kapitale të Brendshme (Ilog.230-231)

Shpenzimet Kapitale në total për MK janë rritur në masën 47.3% në krahasim me vitin 2021, nga ku Programi i Artit dhe Kulturës paraqitet me një rritje në masën prej 46.7% ndërsa Programi i Trashëgimisë Kulturore paraqitet me një rritje në masën prej 166.7% krahasuar me vitin 2021.

Referuar tavaneve të projektbuxhetit për vitin 2022, përsa i përket zërit të investimeve të brëndshme, Ministria e Kulturës do të përqëndrohet në:

Në programin e Artit dhe Kulturës, përfshihet:

1-“**Rijetesimi I Piramides Tirane**” projekt me bashkëfinancim me Bashkinë e Tiranës, që parashikohet për vitet 2021-2024.

2-Dyfishimi i hapësirave të **Galerisë Kombëtare të Arteve**, që sipas Ligjit të Trashëgimisë kthehet në Muze të Arteve të Bukura.

3-“**Restaurim, Rikonstruksion dhe Rinovim salles së Koncerteve ne Universitetin e Arteve, Tirane**” projekt me bashkëfinancim me TAP-in që parashikohet për vitet 2021-2022.

4-“**Projektim dhe Implementim i Mozaikut Tirane**” parashikohet për vitet 2021-2023.

5-Në pritje të përfundimit deri në fund të vititi 2021 të “Hartimit të projektit për Qendrën Kulturore per Femije dhe Teatrit te Kukullave” paraqitet si prioritet për vitet 2022-2024 edhe krijimi i **Qendrës Kombëtare për Fëmijë**.

6-**Ndërtimi i Parkut të Artit, Faza II, 7-Godina e Teatrit Kombëtar**, projekt me bashkëfinancim me Bashkinë e Tiranës dhe parashikuar për vitet 2022-2024.

-Në programin e Trashëgimisë Kulturore dhe Muzetë

1-Planifikuar mbyllja e **Projektit Elektrik per ndricimin e jashtem si Kalaja e Beratit, Shkodrës, Krujës, Gjirokastrës** si dhe planifikuar dhe mbulimi TVSH për projektet IPA.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKLGJIT

Komisioni mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, ka realizuar seanca dëgjimore me aktorë të interesit, si: Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH-në, ATSH-në, QKK-në, universitetet publike, si në Tiranë dhe në rrethe, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.

Akademia e Shkencave

Në raport me parashikimin në projektbuxhetin e Vitit 2022, Akademia si institucioni publik më i lartë, që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish, **kërkon një shtesë prej 20 milionë lekësh**, që lidhet me zbatimin e misionit dhe detyrave kryesore të saj.


Në 000 lekë

Nr. Llog	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
600	Paga	30,000	30,000	30,000	30,000
601	Sigur. shoq. / shëndetësore	4,500	4,500	4,500	4,500
602	Mallra dhe shërbime	50,050	46,700	48,780	52,613
604	Transferta të brendshme	1,000	-	-	-
605	Transferta korrente të huaja	400	600	600	600
606	Transferta për individët	30,000	30,000	30,000	30,000
231	Investime	1,000	1,000	1,000	1,000
	TOTALI	116,950	112,800	114,880	118,713

- Buxheti i parashikuar për vitin 2022 ka një zbritje prej 4.150 mijë lekësh ose rreth 3.6% krahasuar me vitin 2021, në një kohë kur aktiviteti i Akademisë së Shkencave është rritur në mënyrë të ndjeshme.
- Buxheti i parashikuar për vitin 2023 ka një rritje prej 2.080 mijë lekësh ose rreth 1.8% krahasuar me vitin 2022.
- Buxheti i parashikuar për vitin 2024 ka një rritje prej 3.833 mijë lekësh ose rreth 3.3% krahasuar me vitin 2023.

Në grafikun e mëposhtëm është paraqitur buxheti në total (në 000 lekë) për periudhën 2021-2024.

PBA 2022-2024



Sipas produkteve, buxheti i Akademisë së Shkencave përbëhet nga 3 produkte ku peshën specifike më të madhe, rreth 70% , e përbën produkti “92201AA”:

“Veprimtaria e Asamblesë së ASH-së, seksioneve shkencore, Kryesisë, administratës dhe personaliteteve në fushat e shkencës, në përputhje me misionin e saj, pagat dhe pagesat për tituj, ku përfshihen:

- | | |
|---------------------------------------|-----------------|
| 1. pagat | 30 000 000 lekë |
| 2. Sigurimet shoqërore e shëndetësore | 4 500 000 lekë |
| 3. Titulli akademik | 30 000 000 lekë |
| 4. Shpenzime administrative | 10 000 000 lekë |

Kostoja e këtij produkti është 74 500 000 lekë

Produkti 2: “ 92201AB”:

Veprimtaria e seksioneve, njërive kërkimore, komisioneve, veprimtaria promovuese (Veprimtari kërkimore – studimore, projekte, konferenca seminare, ligjërata, kongrese) etj.,

1 Veprimtari kërkimore-studimore, projekte, konkurset e çmimeve 24 700 000

2 Transferta me jashtë (kuota anëtarësimi) 600 000

25 300 000 lekë

Produkti 3:

Publikime shkencore: Botime, monografi dhe revista periodike "Journal of Natural and Technical Sciences" dhe "Studia Albanica" të përzgjedhura kombëtare/ndërkombëtare; Raporte të veprimtarisë së ASHSH-së dhe buletine për veprimtaritë e saj.

Kostoja e produktit është 12 000 000 lekë

1. Botime 12 000 000 lekë

Për sa u përket investimeve tavani buxhetor është 1 000 000 lekë, të detajuara 300 mijë lekë për blerje librash shkencorë dhe 700 mijë lekë për blerje pajisjesh elektronike e informatike.

Siç jeni në dijeni, Akademia e Shkencave është në një proces rinovimi të saj, mundësuar nga Ligji i ri për Akademinë e Shkencave.

Po t'i hedhim një shikim buxheteve të mëparshme, rezultojnë të jenë po i njëjti buxhet me këtë që po paraqesim sot.

Faza e parë e ndryshimit dhe e zhvillimit të Akademisë së Shkencave (Rinovimi dhe Struktura) është realizuar pa asnjë buxhet shtesë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë aktualisht ndodhet në fazën e dytë të zhvillimit të saj, që përfshin atë të marrjes së projekteve. Akademia ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm duke nxitur, organizuar e koordinuar kërkime e studime shkencore në fushat më të reja e më me shumë perspektivë si nano–teknologjitë, bio–teknologjitë, gjenetika, energjitë e rinovueshme, inxhinieri–informatike, robotikë etj., për të cilat janë ngritur dhe lipset të ngrihen njësi operative të studimit për ngritjen e kërkimit shkencor në nivelin e standardit të rajonit.

Akademisë së Shkencave në thelb, i kërkohet që të luajë një rol primar në promovimin, koordinimin, organizimin e drejtimin e kërkimit shkencor në Shqipëri e veçanërisht në drejtim të kërkimit në fushat e albanologjisë për mbrojtjen, pasurimin e përmirësimin e gjuhës standarde.

Për këtë, krahas kërkesave për veprimtarinë shkencore të Akademisë janë dhe kërkesat shtesë të paraqitura në formatin 3 të PBA, ku posaçërisht për zhvillimin e 3 projekteve madhore në Albanologji, si “**Enciklopedia shqiptare**”, “**Fjalor i madh i shqipes**” dhe “**Historia e shqiptarëve**” kemi kërkuar një shtesë rreth 162 000 mijë lekësh në buxhetin e vitit 2022.

Në këtë vit të parë të punës për realizimin e tri projekteve të mëdha, është punuar për t'u ngritur:

- E tërë infrastruktura drejtuese njerëzore, akademike, e cila do të merret me mobilizimin e akademikëve, profesoratis, studiuesve, hartuesve të lëndës dhe deri të redaktorëve, korrektorëve, sekretarive që do të përfshihen në hartimin e secilës nga tri veprat madhore
- Historisë së shqiptarëve - në 3 vëllime
- Fjalori i madh i gjuhës shqipe-120 000 fjalë
- Enciklopedia e shqiptarëve - në 10 vëllime
- Është komunikuar me kolegët e Akademisë së Shkencave të Kosovës dhe të Institutit Albanologjik të Prishtinës në disa takime me ta, për të këmbyer mendime dhe për të realizuar marrëveshjet konkrete ligjore, për mobilizimin e stafëve akademike në hartimin e tri veprave të mëdha.
- Janë realizuar një numër takimesh mes stafëve akademike për të formatuar stafet pjesëmarrëse në këto tri ndërmarrje të mëdha dhe ndarjet e punëve së bashku me ta.
- Janë hartuar, në një punë të përbashkët tërë strukturat paraprake të veprave shkencore.
- Është evidentuar inventari i literaturës bazë që do të përdoret si mbështetje për hartimin e veprave, fjalorë të huaj, enciklopedi, botime historike, ato të shkencave ekzakte, të shkencave humane etj., që do të mbështesin.
- Janë bërë pagesat për bibliotekat – on line që do të shërbejnë si bazë e gjerë të dhënash dhe literature në punët me tri veprat.
- Eshtë krijuar baza logjistike dhe infrastruktura si dhe ambientet e reja të punës me fondin 4 000 mijë lekë, ku është mundësuar një server i fuqishëm, kompjutera, laptopë, skanera, tavolina dhe poltrone, kondicionerë, pajisje zyre etj.
- Janë kryer punime për hapjen e ambienteve të reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zyrat që do të ngrihen në funksion të punës së mësipërme.
- Janë mobilizuar dhe është bërë ndarja e punës për një pjesë të mirë të profesoratis dhe studiuesve shkencorë që do të merren me hartimet e teksteve.
- Janë bërë mbledhje periodike me grupet e punës ku janë debatuar gjatë ndarjet e kapitujve, vëllimeve, sytheve, periudhat historike, përgjegjësit e periudhave dhe përgjegjësit e nëngrupeve etj.

Fondi shtesë i kërkuar, që tashmë është miratuar në parim paraprakisht me VKM nr 442, datë 22.07.2021 përputhet me vlerën përfundimtare të preventivave të shpenzimeve për hartimin dhe realizimin e tri projekteve madhore në Albanologji, në vlerën 581 993 mijë lekë për 4-5 vjet, projekte që zënë fill që nga viti aktual, ku me VKM 18, datë 21.01.2021 u miratua nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit fondi prej 100 000 mijë lekësh. Deri më tani shpenzimet kanë qenë minimale nga ky buxhet i miratuar, pasi puna përgatitore në

përzgjedhjen e përcaktimin e grupit të autorëve e bashkëpunëtorëve është një proces i rëndësishëm që kërkon kohën e vetë. Pritet që puna e bërë deri më tani, rreth 40 % e saj, të paguhet konformë ligjeve dhe udhëzimeve për menaxhimin e buxhetit.

Për vitin e ardhshëm është parashikuar një fond prej përfshirë dhe Kosovën, por me ritmet që kanë dy vitet e para e në pritje të rakordimit me dy qeveritë të Enciklopedinë duhet që fondi dhënë prej 100 milion të kalojë vitin tjetër. Ky buxhet është i domosdoshëm për vijimin e punës së nisur dhe ritmeve për të kapur afatin për realizimin në kohë të tyre. *Mosfinancimi i këtyre projekteve do të përbënte një ndërprerje të panevojshme dhe të dëmshme në këtë infrastrukturë të ngritur, dekurajim të punës së studiuesve dhe bashkëpunëtorëve shkencorë dhe në fund të fundit mosfinancimi i këtij viti do të përbënte dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.*

Komisioni mbështetet kërkesën e Akademisë së Shkencave për shtesë fondi prej 20 milionë lekësh, për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

RTSH

Sipas projekteve në projektbuxhetin e vitit 2022, për RTSH-në janë parashikuar fondet në vijim:

FINANCIMI BUXHETOR RTSH	<i>Parashikimi vitit 2022 (në milion lekë)</i>
Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit e shërbimi në gjuhë të huaj	280
Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	65
Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	63
Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	210
TOTALI	618

B -Financimi buxhetor në milionë lekë gjatë katër viteve të fundit dhe vitit 2022 paraqitet në vijim:

TË ARDHURAT	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Financimi nga buxheti	865	765	624	634	606
Shërbimi për Shqipt.jashtë e shërb.gjuhë të huaj	245	240	240	270	220
Projekte filmike & artistike	63	65	74	60	60
Orkestra Simfonike RTSH	57	60	60	54	60

Projekte teknike, investime dhe mirëmbajtje	500	400	250	250	266
---	-----	-----	-----	-----	-----

Nisur nga kërkesat e domosdoshme që duhen realizuar projektet dhe veprimtaritë në vijim gjatë vitit 2021, RTSH kërkon shtesë në Buxhetin e Shtetit për këtë institucion në vlerën 336 milionë lekë.

1.Për programin Orkestra Simfonike e RTSH-së kerkohet shtese fondi ne masen 10 milion leke

2.Për projekte teknike për futjen e teknologjive të reja, sipas dy drejtimeve kryesore në vijim:

a)Në projektet teknike emergjente për veprimtarinë e përditshme kërkohet shtesë financimi në vlerën 60 milionë lekë “Për Shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit”.

b.Për Investimet në teknologji në projekte afatgjata, i rishikuar në këtë material, kërkohet shtesë financimi në vlerën minimale 400 milionë lekë.

Nga sa më sipër shtesat në investime ne teknologji dhe mirembajtje e rrjetit te digjitalizimit konsistojnë në vlerën 460 milionë lekë në vitin 2022.

RTSH kërkon një shtesë financimi buxhetor për vitin 2022,

Në milionë lekë

FINANCIMI BUXHETOR RTSH	VITI 2022
Orkestra Simfonike RTSH dhe Kinematografisë	10
Projekte tekn.për futjen e tekn.reja(shërb. mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit)	60
Totali i kërkesave emergjente	70
Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja investime(Digjitalizimi Arkivës së RTSH, sistemi i transmetimit FM dhe satelit)	400
Totali i kërkesave shtesë Viti 2021	470

Komisioni sugjeron që të mbështetet RTSH për kryerjen e veprimtarisë tij.

ATSH

Agjencia Telegrafike Shqiptare është një institucion klasik dhe unik i medias publike, që informon publikun nëpërmjet zhanrit më klasik, lajmit pa asnjë koment dhe deformim, lajm që shpërndahet jo vetëm në shqip, por edhe në anglisht dhe frëngjisht. ATSH transmeton lajme nga bota apo rajoni të marra nga agjencitë partnere, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, si agjencia prestigjioze gjermane DPA, ajo franceze AFP, italiane ANSA etj..

Duke ndjekur modelin e shumë agjencive të rëndësishme botërore, ATSH synon që përmes lajmeve të jetë kontributor i diplomacisë ekonomike, duke informuar mbi ligjet, aktet e rëndësishme për çështjen e investimeve, tregun shqiptar të kapitaleve, resurset turistike që paraqet vendi ynë.

ATSH kërkon shtesë rreth 5,000,000 milion lekë të reja në buxhetin e vitit 2022 për digjitalizimin e arkivit të fotografisë dhe buletinëve të shkruar, në total rreth 4000 buletinë dhe rreth 250.000 foto projekt ky i ndarë në 4 faza.

Komisioni sugjeron që ATSH të mbështet me shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022 në vlerën e 5.000.000 milion lekëve.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë(QKK)

Përsa i përket Buxhetit të vitit 2022, për QKK kërkon një shtesë fondi prej 50 milion lekë nga të cilat 20 milion kërkojnë për të aplikuar **projektin Minority Co-production**. Aktualisht nga aplikimi I kësaj skeme janë mbështetur 21 projekte për filma me metrazh të gjatë. Këto filma kanë pasur ecuri shumë të mirë në festivalet ndërkombëtare dhe disa prej tyre janë vlerësuar me çmime të rëndësishme.

Projekti Festivali i 14-të i Filmit Shqiptar si manifestim tradicional i vlerave të filmit shqiptar, është menduar të jetë një stacion shumë i rëndësishëm i analizës dhe ballafaqimit të sfidave, vështiresive e problemeve të kinemasë. Ky aktivitet është menduar të zhvillohet në vigjilje të 110 vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. QKK do të marrë të gjitha atributet e kësaj ngjarjeje të rëndësishme për kinematografinë shqiptare duke u pasqyruar si I tillë në promovimet mediatike, postera, intervista etj.

Projekti Studente të financuar për diplomat Bachelor të U.A. Ky angazhim po implementoet me sukses për të dytin vit radhazi, por përben edhe një detyrim financiar I cili Rendon buxhetin e QKK çdo vit. Në këto kushte në përmbushje të angazhimit të marrë për shtesë nga qeveria, si dhe për të garantuar vazhdimësinë e mbështetjes financiare të projektit nevojitet një shtesë buxheti në masën 10 milion.

Komisioni sugjeron që QKK të mbështet me shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022 në vlerën e 50 milion lekëve.

Akademia e Studimeve Albanologjike

Akademia e Studimeve Albanologjike ka për vitin 2022 një buxhet me vlerë 220,000,000.

ASA kërkon një shtesë buxheti prej 114,453,352 pra, në total 351,453,352 të cilat përkthehen në:

- 1.Konferenca shkecore brenda dhe jashtë vendit
- 2.Investime (rikonstruksin, përlëvizje paisje gunder zjarrit, blerje kompjutera, blerje program kompjuterik për fondet, arkivat, biblioteka, blerje rafta metalike për bibliotekë dhe arkivat ASA, blerje dy mikrobuzëve për ekspedita, blerje automjet foristrad për ekspedita, ndërtimi I platformes digjitale për fondet arkeologjike të institutit të arkeologjisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, duke u mbështetur në implementimin e prioritetëve të filluara në 3-4 vitet e fundit për këtë institucion. Ne pergatitjen e project buxhetit afat mesem 2022-2024 kane kerkuar financimin me fondin prej 50 milion lek per rikonstruksionin e nje godine per krijimin e muzeut per pasqyrimin e Fondeve Arkivore e historike me vlere te pa zevendesueshme te trashegimise sone kombetare, e cila eshte parashikuar per vitin 2022. Gjithashtu me qellim qe informacioni I kerkuar te jete sa me I shpejte dhe efikas kane kerkuar nje fond shtese prej 10 milion leke ne vit per tre vjet per digjitalizimin e audio dhe video, pre te cilave jane pasqyruar ne projekt 5 milion per vitin 2022.

Komisioni sugjeron që të mbështetet kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për të realizuar veprimtarinë e saj.

Universitetet publike

Në seancat dëgjimore të organizuara me universitetet publike të Tiranës dhe të rretheve, drejtuesit e tyre kërkuan mbështetje në buxhet për vitin 2022.

Universiteti i Mjekësisë kërkon shikimin e mundësive për financimin e projekteve të mëposhtëme:

-Rikonstruksioni i dy godinave të dëmtuara nga tërmeti, të mbyllura bazuar në ekspertizën e institucioneve përkatëse, që kanë kryer vlerësimin e shkallës së dëmtimit dhe të sigurisë. Shtesë e jashtme për fakultetin e Mjekësisë Dentare, si dhe shtesë kati mbi godinat egzistuese në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.

- Zhvillimi dhe krijimi i kushteve bashkëhore për salla, laboratorë dhe ambiente të tjera studimi kërkon zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese. Këto dy projekte do t'i shërbejnë pikërisht këtij qëllimi. Për realizimin e shtesës së jashtme për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, kërkohet një bashkëpunim ndërmjet UMT-së , MASR-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Universiteti Bujqësor i Tiranës kërkon:

1. Garantimin e financimit të Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore të Stafit Akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të Universitetit Bujqësor të Tiranës për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të UBT_së; shtesë fondi për Bankën Gjenetike; të fillojë sa më shpejt ndërtimi i godinës së Bioteknologjisë; për vitin tjetër të financohet ngritja e një klinike veterinare. **Garantimi i financimit të plotë të fondit të Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore** për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të UBT, për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të tij ne vleren prej **780,400,000 lekë**.
2. Mbështetje financiare për aktivitetin e **Institutit të Resurseve Gjenetike të Bimëve** (ish-Banka Gjenetike), Institutin e Peshkimit, Durres dhe Fermën Didaktike Eksperimentale pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës ne vleren prej **50,000,000 lekë**.
3. Mbështetje financiare për **financimin e 30% të totalit të vlerës për rindërtimin e Godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit**, pjesë e cila sipas marveshjes

me MARS duhet të paguhet nga të ardhurat e Universitetit. Kjo masë financimi shkakton vështirësi në menaxhimin e Universitetit për dy vitet e ardhshme. Vlera e kërkuar është prej **75,796,000 lekë**.

4. Rindërtimi i **Godinës së Fakultetit të Shkencave Pyjore**. Bazuar në **VKM nr. 26 datë 15.01.2020** “Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e demtuara nga termeti”, i është kërkuar nga ana jonë Universitetit Politeknik të Tiranës të kryejë një akt-ekspertizë të thelluar për qëndrueshmërinë e **Godinës së Fakultetit të Shkencave Pyjore**. Sipas akt-ekspertizës së thelluar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për Godinën e Fakultetit të Shkencave Pyjore, **rekomandohet që të shikohet mundësia e rindërtimit të kësaj godine**. Kjo godine është ndërtuar në vitin 1985, ka katër kate mbi tokë dhe një kat nën dhe, me një sipërfaqe totale prej 3842.7 m². Për ndërtimin e kësaj godine është hartuar një projekt i cili parashikon një fond **prej afro 3.5 milion Euro**.
5. Rindërtimi i **Godinës së Klinikës Veterinare për nevojat e studenteve të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare**. Akt-ekspertiza e thelluar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për Godinën e Klinikës Veterinare dhe Laboratorin e Anatomisë për studentet e Fakultetit të Mjekësisë veterinarë ka konkluduar që **kjo godine duhet të rindërtohet**, si një godine e demtuar nga termeti i Nentorit 2019. Kjo godine ka rreth 50 vjet shfrytëzimi dhe nuk reflekton kushtet dhe standartet për funksionimin si një Laborator. Edhe për këtë godine është hartuar një projekt i cili kërkon një vlerë prej **afro 400 000 Euro**.

Universiteti i Sporteve kërkon mbështetjen dhe miratimin e buxhetit për vitin 2022 në vlerën 2,462,940 leke.

Në vitin 2022 në grandin e mësimdhënies duhen 367,749 mijë lekë universitetin e sporteve.

Investimet kryesore për të cilat janë gati projektet dhe kërkesat mbështetje janë :

1.Pista atletike dhe fusha e futbollit me kërkesat bashkfinancim dhe me të ardhurat e universitetit në vitin 2021 me vlerë prej 99 778 000 leke.

2.Shtesa e palestres së gjimnastikës me vlerë prej 31 912 000 leke.

3.Pishina me ambjentet ndihmëse me vlerë prej 313 000 000 leke.

4.Prishja e një godine të vjetër dy kateshë dhe ndërtimi i një godine të re katër kateshë sipas standarteve për të plotësuar nevojat për ambjente dhe për fakultetin e ri të shkencave të rehabilitimit dhe të sallave dhe ambjenteve për dy fakultetet e tjera në vlerën prej 120 000 000 leke.

5. Rikonstrukcione godinat e vjetra ku ndodhen zyrat e rektoratit, administratës, kabinetet e ambjenteve për seminare dhe laborator sipas standarteve me vlerë prej 100 000 000.

Universiteti i Tiranës kërkon mbështetjen dhe miratimin e buxhetit për vitin 2022 në vlerën 2,462,940 leke.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan kërkon rritjen e investimeve, mbështetjen e projekteve kërkimore shkencore, ndërtimin e godinës së fakultetit të shkencave humane, ndërtimin e fakultetit të shkencave mjekësore.

Universiteti “Fan S. Noli” kërkon rikonstruksinin ose ndërtimin e godinës së fakultetit të edukimit dhe filologjisë si dhe një godine për departamentin e infermierisë, për të cilat kërkon mbulimin me fondin pasi nuk mund të përballojë me të ardhurat e veta.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës kërkon: fonde për kërkimin shkencor.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë kërkon të mbështetet me fonde për rikonstruksionin e godinës së ushtarakëve.

Universiteti i Arteve kërkon mbështetjen dhe miratimin për buxhetin e kërkuar 2022.

IV.QENDRIMI I OPOZITËS

Gjatë gjithë takimeve, deputetët e Opozitës vërejtën rastet e shmangies së prioriteteve të caktuara nga plani për arsimin dhe kulturën dhe sugjeruan ndryshime përmirësuese, duke shprehur se në tërësinë e tij Projektbuxheti për Arsimin dhe Kulturën nuk reflekton nevojat konkrete kombëtare dhe nuk reflekton përmirësime në problemet e mbartura, nuk pasqyron nevojat gjithëpërfshirëse dhe nuk jep hollësitë për probleme të caktuara që kanë qenë edhe debate publike. Ata sugjerojnë që Ministrinë e linjës t'i kenë në konsideratë vërejtjet e tyre konstruktive në draftin përfundimtar të Buxhetit, sa kohë ato janë për përmirësimin e punës së institucioneve, si edhe për përmirësimin e jetës së shqiptarëve. Deputetët e Opozitës dhanë mbështetjen e tyre për fondet shtesë në buxhetet e disa institucioneve të pavarura arsimore e kulturore, për përmirësimin e performancës së tyre.

V.DISKUTIMI NË KOMISION

Në diskutimin në parim për projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022”, gjatë seancave me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera, u fol gjerësisht për projektligjin dhe u diskutua, në mes të tjerash, për kushtet kur diskutohet ky buxhet, qëndrueshmërinë e tij, përmbushjen e Programit të Qeverisë Shqiptare, prioritetet e saj, ku arsimi, kultura, shkenca e sporti kanë vëmendje të veçantë, gjë që shprehet, në mes të tjerash, në rritjen e buxhetit në disa drejtime. Në mbështetje të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022”, u shpreh deputeti Petro Koçi, si dhe deputetë të tjerë të mazhorancës, ndërsa ishin kundër projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022” deputetët e Opozitës.

V. PËRFUNDIM.

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022” në tërë komponentët e tij, me shumicë votash miratoi në parim projektligjin dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Lindita Buxheli

Ilir Topi

Flutura Aça

Luçiano Boçi

KRYETAR

Agron Gjekmarkaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dekument Parlamentar)

Tiranë, më 18.11.2022

RAPORT

PËR DISKUTIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI TË PROJEKTLIGJIT

“ PËR BUXHETIN E VITIT 2022 ”

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në disa seanca të mbledhjeve të tij të datave 02,03,05,08 nëntor 2021, mori në shqyrtim në parim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave.

Relatorë të projektligjit janë: znj. Lindita Buxheli, znj. Flutura Açka, z. Ilir Topi, z. Luçiano Boçi.

Në diskutimin në parim të projektligjit ishin të pranishme dhe dhanë shpjegime rreth tij znj. Evis Kushi, Ministre e Arsimit dhe Sportit; znj. Elva Margariti, Ministre e Kulturës; përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe ekspertë të ministrive përkatëse. Gjithashtu, u organizuan seanca dëgjimore me institucione që financohen edhe nga Buxheti i Shtetit.

III. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

IV. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Sipas relacionit shoqërues, që në fillim theksohet se Projektbuxheti 2022 synon rimëkëmbjen ekonomike të vendit, përmes skemave të punësimit, mbështetjes proaktive ndaj biznesit, rindërtimit të plotë të banesave të qytetarëve të prekur nga tërmeti, si dhe marrjen e masave parandaluese të përhapjes së mëtejshme të COVID-19.

Në projektbuxhetin e vitit 2022, **programimi i të ardhurave buxhetore** mbështet synimet e Qeverisë për rimëkëmbjen ekonomike, si dhe mbajtjen nën kontroll të defiçitit buxhetor dhe borxhit publik. Në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskalë, në ligjin organik të buxhetit, politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal në periudhën afatmesme dhe afatgjatë etj..

Buxheti i MAS 2020

Buxheti për arsimin dhe sportin vazhdon trendin rritës si në vlera nominale, ashtu dhe në përqindje ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2022, me synimin të përmbushë objektivat dhe

angazhimet e Qeverisë, por duke reflektuar padyshim edhe të gjitha masat e marra për kapërcimin e pasojave të tërmetit të 26 nëtorit dhe situatës së pandemisë Covid-19.

Fondet për sektorin e arsimit në vitin 2022 janë 65.6 miliardë lekë. Fondet përfaqësojnë 10.2% ndaj shpenzimeve të buxhetit apo 3.51 % ndaj produktit të brendshëm bruto.

Fondet buxhetore për MAS për vitin 2022 janë planifikuar 45 miliardë e 658 milionë lekë, që në krahasim me fondet e rishikuara të vitit 2021 kanë një rritje prej 2 miliardë e 676 milionë lekë, ose 6.2%.

Buxheti të MAS-it për vitin 2022 do t'i shtohet edhe shtesa e pagave prej 6% për të gjithë punonjësit mësimorë dhe punonjësit psikosocialë.

Për arsimin parauniversitar

Fondet totale për arsimin parauniversitar janë 51.2 miliardë lekë.

Krahasuar me buxhetin e rishikuar 2021, buxheti për arsimin parauniversitar ka një rritje në vlerë nominale me 1 miliard e 912 milion lekë ose 6,2% krahasuar me vitin 2021, ku shpenzimet kapitale janë rritur 1,2 miliardë lekë dhe shpenzimet korente 691 milion leke.

Arsimi profesional dhe punësimi

Buxheti i planifikuar për Programin e Arsimit të mesëm profesional për vitin 2022 është 3 miliardë e 63 milionë lekë.

Politika e këtij programi synon të përmbushë qëllimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 dhe planit të saj të veprimit, të identifikojë dhe hartojë politikat e duhura për punësimin, arsimin dhe formimin profesional, në mënyrë që të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore për punësim dhe aftësi përgjatë gjithë ciklit të jetës.

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor

Për vitin 2022, buxheti i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (pa përfshirë fondet jashtëbuxhetore) është planifikuar në një vlerë totale prej 11 miliardë e 752 milionë lekësh.

Buxheti 2022 i MAS për programin buxhetor “Arsimi i Lartë” ka shënuar një rritje prej 9% ose 910 milion lekë më shumë sesa buxheti 2021, rritje që do të fokusohet për projektet e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë dhe projekte të përbashkëta të IAL-ve publike.

Gjithashtu, edhe buxheti i vitit 2022 i MAS për programin buxhetor “Kërkimi Shkencor” ka një rritje me 9% ose 66 milionë lekë më shumë krahasuar me vitin 2021.

Për Artin dhe Kulturën

Ministria Kulturës procesin e hartimit të PBA-së 2022 e ka vlerësuar si një moment të rëndësishëm, në mbështetje të objektivave të Programit të Qeverisë, duke respektuar gjithashtu tavanet përfundimtare për vitet 2022-2024, me qëllim zhvillimin e Art-Kulturës si dhe Trashëgimisë Kulturore & Muzetë. Nisur nga treguesit, projektbuxheti i vitit 2022 krahasuar me buxhetin e vitit 2021 ka një rritje prej 46.6% ose 1.3 miliardë lekë, kjo si rezultat i rritjes së shpenzimeve korrente dhe kapitale.

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Komisioni mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, pas organizimit të disa seancave dëgjimore gjatë diskutimit të projektligjit në parim me ministritë e linjës, Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH, ATSH, QKK, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, si dhe universitetet publike të Tiranës dhe ato të rretheve, në vijim të këtij procesi në diskutimin nen për nen dhe në tërësi, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, organizoi seanca dëgjimore me Shoqatën e Botuesve të Librit Shkollor, Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë, Sindikatën e Pavarur të Arsimitarëve, Sindikatën

e Punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë, CRCA, Koalicionin për Arsim në Shqipëri, Qendrën "Për Arsim Cilësor", Qendrën për Advokim Social, Qendrën për Organizim dhe Fuqizim Komunitar, Qendrën për Aksion Komunitar, Lëvizjen Rinore Egjiptiane - Rome, Qendrën "Treja".

Akademia e Shkencave

- Në raport me parashikimin në projektbuxhetin e Vitit 2022, Akademia si institucioni publik më i lartë, që përfaqëson e mbart vlerat më të mira të shkencës, të kërkimit shkencor, të krijimtarisë dhe të debatit e bashkëveprimit të mendimit shkencor në vend, përmes një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh e krijuesish, **kërkon një shtesë prej 20 milionë lekësh**, që lidhet me zbatimin e misionit dhe detyrave kryesore të saj. Buxheti i parashikuar për vitin 2022 ka një zbritje prej 4.150 mijë lekësh ose rreth 3.6% krahasuar me vitin 2021, në një kohë kur aktiviteti i Akademisë së Shkencave është rritur në mënyrë të ndjeshme.

Për këtë, krahas kërkesave për veprimtarinë shkencore të Akademisë janë dhe kërkesat shtesë të paraqitura në formatin 3 të PBA, ku posaçërisht për zhvillimin e 3 projekteve madhore në Albanologji, si **"Enciklopedia shqiptare"**; **"Fjalori i madh i shqipes"** dhe **"Historia e shqiptarëve"** kemi kërkuar një shtesë rreth 162 000 mijë lekësh në buxhetin e vitit 2022.

Në këtë vit të parë të punës për realizimin e tri projekteve të mëdha, është punuar për t'u ngritur:

- E tërë infrastruktura drejtuese njerëzore, akademike, e cila do të merret me mobilizimin e akademikëve, profesoratit, studiuesve, hartuesve të lëndës dhe deri të redaktorëve, korrektorëve, sekretarive që do të përfshihen në hartimin e secilës nga tri veprat madhore:
- Historisë së shqiptarëve - në 3 vëllime.
- Fjalori i madh i gjuhës shqipe-120 000 fjalë.
- Enciklopedia e shqiptarëve - në 10 vëllime.
- Është komunikuar me kolegët e Akademisë së Shkencave të Kosovës dhe të Institutit Albanologjik të Prishtinës në disa takime me ta, për të këmbyer mendime dhe për të realizuar marrëveshjet konkrete ligjore, për mobilizimin e stafeve akademike në hartimin e tri veprave të mëdha.
- Janë realizuar një numër takimesh mes stafeve akademike për të formatuar stafet pjesëmarrëse në këto tri ndërmarrje të mëdha dhe ndarjet e punëve së bashku me ta.
- Janë hartuar, në një punë të përbashkët tërë strukturat paraprake të veprave shkencore.
- Është evidentuar inventari i literaturës bazë që do të përdoret si mbështetje për hartimin e veprave, fjalorë të huaj, enciklopedi, botime historike, ato të shkencave ekzakte, të shkencave humane etj., që do të mbështesin.
- Janë bërë pagesat për bibliotekat – on line që do të shërbejnë si bazë e gjerë të dhënash dhe literature në punët me tri veprat.
- Eshtë krijuar baza logjistike dhe infrastruktura si dhe ambientet e reja të punës me fondin 4 000 mijë lekë, ku është mundësuar një server i fuqishëm, kompjutera, laptopë, skanera, tavolina dhe poltrone, kondicionerë, pajisje zyre etj..
- Janë kryer punime për hapjen e ambienteve të reja dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për zyrat që do të ngrihen në funksion të punës së mësipërme.
- Janë mobilizuar dhe është bërë ndarja e punës për një pjesë të mirë të profesoratit dhe studiuesve shkencorë që do të merren me hartimet e teksteve.
- Janë bërë mbledhje periodike me grupet e punës ku janë debatuar gjatë ndarjet e kapitujve, vëllimeve, sytheve, periudhat historike, përgjegjësit e periudhave dhe përgjegjësit e nëngrupeve etj..

Fondi shtesë i kërkuar, që tashmë është miratuar në parim paraprakisht me VKM nr 442, datë 22.07.2021, përputhet me vlerën përfundimtare të preventivave të shpenzimeve për hartimin dhe

realizimin e tri projekteve madhore në Albanologji, në vlerën 581 993 mijë lekë për 4-5 vjet, projekte që zënë fill që nga viti aktual, ku me VKM 18, datë 21.01.2021, u miratua nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit fondi prej 100 000 mijë lekësh. Deri më tani shpenzimet kanë qenë minimale nga ky buxhet i miratuar, pasi puna përgatitore në përzgjedhjen e përcaktimin e grupit të autorëve e bahkëpunëtorëve është një proces i rëndësishëm që kërkon kohën e vetë. Pritet që puna e bërë deri më tani, rreth 40 % e saj, të paguhet konformë ligjeve dhe udhëzimeve për menaxhimin e buzhetit.

Për vitin e ardhshëm është parashikuar një fond në të cilin përfshihet edhe Kosova, por me ritmet që kanë dy vitet e para e në pritje të rakordimit me dy qeveritë për Enciklopedinë, duhet që fondi dhënë prej 100 milionë lekësh të kalojë vitin tjetër. Ky buxhet është i domosdoshëm për vijimin e punës së nisur dhe ritmeve për të kapur afatin për realizimin në kohë të tyre. *Mosfinancimi i këtyre projekteve do të përbënte një ndërprerje të panevojshme dhe të dëmshme në këtë infrastrukturë të ngritur, dekurajim të punës së studiuesve dhe bashkëpunëtorëve shkencorë dhe në fund të fundit mosfinancimi i këtij viti do të përbënte dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.*

Komisioni mbështet kërkesën e Akademisë së Shkencave për shtesë fondi prej 20 milionë lekësh, për realizimin me efektivitet të veprimtarisë së saj.

RTSH

Sipas projekteve në projektbuxhetin e vitit 2022, për RTSH-në janë parashikuar fondet në vijim:

FINANCIMI BUXHETOR RTSH	Parashikimi vitit 2022 (në milion lekë)
Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit e shërbimi në gjuhë të huaj	280
Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	65
Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografisë	63
Projekte Teknike për Futjen e Teknologjive të Reja	210
TOTALI	618

B -Financimi buxhetor në milionë lekë gjatë katër viteve të fundit dhe vitit 2022 paraqitet në vijim:

TË ARDHURAT	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Financimi nga buxheti	865	765	624	634	606
Shërbimi për shqiptarët jashtë e shërbimi në gjuhë të huaj	245	240	240	270	220
Projekte filmike & artistike	63	65	74	60	60
Orkestra Simfonike RTSH	57	60	60	54	60
Projekte teknike, investime dhe mirëmbajtje	500	400	250	250	266

Nisur nga kërkesat e domosdoshme që duhen realizuar projektet dhe veprimtaritë në vijim gjatë vitit 2021, RTSH kërkon shtesë në Buxhetin e Shtetit për këtë institucion në vlerën 336 milionë lekë.

- 1.Për programin Orkestra Simfonike e RTSH-së kërkohet shtesë fondi në masën 10 milionë lekë;
- 2.Për projekte teknike për futjen e teknologjive të reja, sipas dy drejtimeve kryesore në vijim:

a) Në projektet teknike emergjente për veprimtarinë e përditshme kërkohet shtesë financimi në vlerën 60 milionë lekë “Për Shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit”.

b) Për investimet në teknologji në projekte afatgjata, i rishikuar në këtë material, kërkohet shtesë financimi në vlerën minimale 400 milionë lekë.

Nga sa më sipër shtesat në investime në teknologji dhe mirëmbajtje të rrjetit të digjitalizimit konsistojnë në vlerën 460 milionë lekë në vitin 2022.

RTSH kërkon një shtesë financimi buxhetor për vitin 2022

Në milionë lekë

FINANCIMI BUXHETOR RTSH	VITI 2022
Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografisë	10
Projekte tekn.për futjen e tekn.reja(shërb. mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit)	60
Totali i kërkesave emergjente	70
Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja investime(digjitalizimi Arkivës së RTSH, sistemi i transmetimit FM dhe satelit)	400
Totali i kërkesave shtesë Viti 2021	470

ATSH

Agjencia Telegrafike Shqiptare është një institucion klasik dhe unik i medias publike, që informon publikun nëpërmjet zhanrit më klasik, lajmit pa asnjë koment dhe deformim, lajm që shpërndahet jo vetëm në shqip, por edhe në anglisht dhe frëngjisht. ATSH transmeton lajme nga bota apo rajoni të marra nga agjencitë partnere, me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, si agjencia prestigjioze gjermane DPA, ajo franceze AFP, italiane ANSA etj..

Duke ndjekur modelin e shumë agjencive të rëndësishme botërore, ATSH synon që përmes lajmeve të jetë kontributor i diplomacisë ekonomike, duke informuar mbi ligjet, aktet e rëndësishme për çështjen e investimeve, tregun shqiptar të kapitaleve, resurset turistike që paraqet vendi ynë.

ATSH kërkon shtesë rreth 5,000,000 milionë lekë të reja në buxhetin e vitit 2022 për digjitalizimin e arkivit të fotografisë dhe buletinëve të shkruar, në total rreth 4000 buletinë dhe rreth 250.000 foto, projekt ky i ndarë në 4 faza.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë(QKK)

Përsa i përket Buxhetit të vitit 2022, QKK kërkon një shtesë fondi prej 50 milionë lekësh, nga të cilat 20 milionë kërkohen për të aplikuar **projektin Minority Co-production**. Aktualisht nga aplikimi i kësaj skeme janë mbështetur 21 projekte për filma me metrazh të gjatë. Këto filma kanë pasur ecuri shumë të mirë në festivalet ndërkombetare dhe disa prej tyre janë vlerësuar me çmime të rëndësishme.

Projekti Festivali i 14-të i Filmit Shqiptar, si maifestim tradicional i vlerave të filmit shqiptar, është menduar të jetë një stacion shumë i rëndësishëm i analizës dhe ballafaqimit të sfidave, vështirësive e problemeve të kinemasë. Ky aktivitet është menduar të zhvillohet në vigjilje të 110 vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar. QKK do të marrë të gjitha atributet e kësaj ngjarjeje të rëndësishme për kinematografinë shqiptare, duke u pasqyruar si i tillë në promovimet mediatike, postera, intervista etj..

Projekti Studentë të financuar për diplomat Bachelor të U.A. Ky angazhim po implementohet me sukses për të dytin vit radhazi, por përbën edhe një detyrim financiar, i cili rëndon buxhetin e QKK çdo vit. Në këto kushte, në përmbushje të angazhimit të marrë përsipër nga qeveria,

si dhe për të garantuar vazhdimësinë e mbështetjes financiare të projektit, nevojitet një shtesë buxheti në masën 10 milionë lekë.

Akademia e Studimeve Albanologjike

Akademia e Studimeve Albanologjike ka për vitin 2022 një buxhet me vlerë 220,000,000. ASA kërkon një shtesë buxheti prej 114,453,352, pra, në total 351,453,352, të cilat përkthehen në:

1. Konferenca shkecore brenda dhe jashtë vendit;
2. Investime (rikonstruksin, blerje pajisjesh kundër zjarrit, blerje kompjuterash, blerje programesh kompjuterike për fondet, arkivat, bibliotekat, blerje raftesh metalike për bibliotekën dhe arkivën e ASA, blerje e dy mikrobuzeve për ekspedita, blerje automjetesh fuoristradë për ekspeditat, ndërtimi i platformës digjitale për fondet arkeologjike të Insitutit të Arkeologjisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, duke u mbështetur në implementimin e prioritetëve të filluara në 3-4 vitet e fundit për këtë institucion, në përgatitjen e projektbuxhetit afatmesëm 2022-2024 kanë kërkuar financimin me fondin prej 50 milionë lekësh për rikonstruksionin e një godine për krijimin e muzeut për pasqyrimin e Fondeve Arkivore e Historike me vlera të pazëvendësueshme të trashëgimisë sonë kombëtare, e cila është parashikuar për vitin 2022. Gjithashtu, me qëllim që informacioni i kërkuar të jetë sa më i shpejtë dhe efikas, kanë kërkuar një fond shtesë prej 10 milionë lekësh në vit për tre vjet për digjitalizimin e sistemit audio dhe video, prej të cilave janë pasqyruar në projekt 5 milionë lekë për vitin 2022.

Universitetet publike

Në seancat dëgjimore të organizuara me universitetet publike të Tiranës dhe të rretheve, drejtuesit e tyre kërkuar mbështetje në buxhet për vitin 2022.

Universiteti i Mjekësisë kërkon shikimin e mundësive për financimin e projekteve të mëposhtëme:

1. Rikonstruksioni i dy godinave të dëmtuara nga tërmeti, të mbyllura bazuar në ekspertizën e institucioneve përkatëse, që kanë kryer vlerësimin e shkallës së dëmtimit dhe të sigurisë. Shtesë e jashtme për fakultetin e Mjekësisë Dentare, si dhe shtesë kati mbi godinat egzistuese në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike.

2. Zhvillimi dhe krijimi i kushteve bashkëkohore për salla, laboratorë dhe ambiente të tjera studimi kërkon zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese. Këto dy projekte do t'i shërbejnë pikërisht këtij qëllimi. Për realizimin e shtesës së jashtme për Fakultetin e Mjekësisë Dentare, kërkohet një bashkëpunim ndërmjet UMT-së, MAS-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Universiteti Bujqësor i Tiranës kërkon:

1. Garantimin e financimit të pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të Universitetit Bujqësor të Tiranës, për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të UBT-së; shtesë fondi për Bankën Gjenetike; të fillojë sa më shpejt ndërtimi i godinës së Bioteknologjisë; për vitin tjetër të financohet ngritja e një klinike veterinarë. **Garantimi i financimit të plotë të fondit të Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore** për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të UBT, për sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit të tij në vlerën prej **780,400,000 lekë;**

2. Mbështetje financiare për aktivitetin e **Institutit të Resurseve Gjenetike të Bimëve** (ish-Banka Gjenetike), Institutin e Peshkimit, Durrës, dhe Fermën Didaktike Eksperimentale pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës në vlerën prej **50,000,000 lekë**;
3. Mbështetje financiare për **financimin e 30% të totalit të vlerës për rindërtimin e Godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë dhe Ushqimit**, pjesë e cila sipas marrëveshjes me MAS duhet të paguhet nga të ardhurat e Universitetit. Kjo masë financimi shkakton vështirësi në menaxhimin e Universitetit për dy vitet e ardhshme. Vlera e kërkuar është prej **75,796,000 lekë**;
4. Rindërtimi i **Godinës së Fakultetit të Shkencave Pyjore**. Bazuar në **VKM nr. 26 datë 15.01.2020** “Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara nga tërmeti”, i është kërkuar nga ana jonë Universitetit Politeknik të Tiranës të kryejë një akt-ekspertizë të thelluar për qëndrueshmërinë e **Godinës së Fakultetit të Shkencave Pyjore**. Sipas akt-ekspertizës së thelluar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për Godinën e Fakultetit të Shkencave Pyjore, **rekomandohet që të shikohet mundësia e rindërtimit të kësaj godine**. Kjo godine është ndërtuar në vitin 1985, ka katër kate mbi tokë dhe një kat nën dhe, me një sipërfaqe totale prej 3842.7 m². Për ndërtimin e kësaj godine është hartuar një projekt i cili parashikon një fond prej **afro 3.5 milion euro**;
5. Rindërtimi i **Godinës së Klinikës Veterinare për nevoja të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare**. Akt-ekspertiza e thelluar nga Universiteti Politeknik i Tiranës për Godinën e Klinikës Veterinare dhe Laboratorin e Anatomisë për studentët e Fakultetit të Mjekësisë veterinarë ka konkluduar që **kjo godinë duhet të rindërtohet**, si një godinë e dëmtuar nga tërmeti i Nëntorit 2019. Kjo godinë ka rreth 50 vjet shfrytëzimi dhe nuk reflekton kushtet dhe standartet për funksionimin si një laborator. Edhe për këtë godinë është hartuar një projekt i cili kërkon një vlerë prej **afro 400 000 euro**.

Universiteti i Sporteve kërkon mbështetjen dhe miratimin e buxhetit për vitin 2022 në vlerën 2,462,940 lekë.

Në vitin 2022 në grandin e mësimdhënies duhen 367,749 mijë lekë për Universitetin e Sporteve.

Investimet kryesore për të cilat janë gati projektet dhe kërkon mbështetje janë:

1. Për pistën atletike dhe fushën e futbollit kërkohet bashkfinancim dhe me të ardhurat e universitetit në vitin 2021 me vlerë prej 99 778 000 lekë;
2. Shtesë e palestrës së gjimnastikës me vlerë prej 31 912 000 leke;
3. Pishina me ambjentet ndihmese me vlerë prej 313 000 000 lekë;
4. Prishja e një godine të vjetër dykatëshe dhe ndërtimi i një godine të re katër katëshe sipas standarteve, për të plotësuar nevojat për ambjente dhe për fakultetin e ri të Shkencave të Rehabilitimit dhe të sallave dhe ambjenteve për dy fakultetet e tjera në vlerën prej 120 000 000 lekë;
5. Rikonstruksione për godinat e vjetra, ku ndodhen zyrat e rektoratit, administratës, kabinete e ambjente për seminare dhe laboratorë sipas standarteve me vlerë prej 100 000 000 lekë.

Universiteti i Tiranës kërkon mbështetjen dhe miratimin e buxhetit për vitin 2022 në vlerën 2,462,940 lekë.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan kërkon rritjen e investimeve, mbështetjen e projekteve kërkimore - shkencore, ndërtimin e godinës së Fakultetit të Shkencave Humane, ndërtimin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

Universiteti “Fan S. Noli” kërkon rikonstruksionin ose ndërtimin e godinës së Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, si dhe një godinë për Departamentin e Infermierisë, për të cilat kërkon mbulimin me fonde, pasi nuk mund t'i përballojë me të ardhurat e veta.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës kërkon fonde për kërkimin shkencor.

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë kërkon të mbështetet me fonde për rikonstruksionin e godinës së ushtarakëve.

Universiteti i Arteve kërkon mbështetjen dhe miratimin për buxhetin e kërkuar 2022.

Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë

Ne kemi kërkuar vazhdimisht dhënien e librave falas për të gjithë nxënësit në arsimin e detyrueshëm dhe kemi përshëndetur realizimin e kësaj kërkese nga Qeveria, ashtu siç kemi vlerësuar edhe shtimin e 1000 mësuesve për të zëvendësuar mësuesit që prekeshin nga Covid-19, përfshirjen e mësuesve në grupet prioritare të vaksinimit, si dhe marrjen në konsideratë të kërkesave tona nga ana e MASR për gjetjen e rrugëve dhe mundësive për ruajtjen e vendeve të punës së mësuesve në kushtet e rënies së vazhdueshme të numrit të nxënësve nga emigracioni i lartë dhe tërheqja e një pjese të tyre nga shkollat private.

Me gjithë kërkesat e përvitshme të SPASH për rritjen e buxhetit për arsimin nga rreth 3% që është sot në 5% të GDP dhe pajisjen e shkollave me mjetet e nevojshme mësimore, për një mësimdhënie më cilësore, cilësia në arsimin publik lë shumë për të dëshiruar dhe kjo çdo vit shoqërohet me largimin e një numri të konsiderueshëm të nxënësve nga arsimi publik.

Mungesa e internetit në më shumë se 50% të shkollave rurale (sipas bankës Botërore vetëm 47% e shkollave rurale kanë akses në internet), mungesës së bazës mësimore në kabinete, laboratorë etj. i është shtuar edhe mungesa e regjistrave (deri sot shkollat janë pa regjistra). SPASH, mendon se për ndryshimin e gjendjes duhet rritja e buxhetit për arsimin deri në 5% të GDP, rritja e pagave të mësuesve, të paktën 10% çdo vit.

Transporti: Praktikisht mësuesve nuk u mbulohen 100% shpenzimet e transportit, ashtu siç shkruhet, madje një pjesë e madhe e tyre i marrin ato me disa muaj vonesë, për shkak të fondeve të pamjaftueshme që kanë në dispozicion Zyrat Vendore Arsimore dhe kalimit të këtyre fondeve për shlyerjen e pagesave të mësuesve të larguar padrejtësisht nga puna në shkelje të ligjeve dhe kontratës kolektive nga ana drejtuesve të tyre. Krijimi i ZVA-ve të reja ka shtuar problemet e transportit të mësuesve (sot mësuesit e Belshit kanë 5 muaj pa marre leket e transportit). Ne kemi kërkuar dhe presim zgjidhjen e problemit të transportit të mësuesve që punojnë brenda prefekturës, duke rimbursuar shpenzimet reale për km.

Trajnimi i mësuesve: Fondet e planifikuara në buxhet për trajnimin e mësuesve janë të pamjaftueshme dhe nuk i përgjigjen zbatimit të nenit 58 të ligjit 69/2012. Të parashikohet fond i veçantë për trajnimin e mësuesve për jo më pak se tri ditë në vit, ashtu siç është parashikuar në nenin 58, pika 3 e ligjit 69/2012. Trajnimet e mësuesve duhet të jenë falas dhe të bëhen nga fakultetet e mësuesisë sipas lëndëve, për të cilat janë diplomuar. Nëse MAS nuk është në gjendje të trajnojë mësuesit falas, ashtu siç parashikohet në ligj, atëherë le të bëjmë atë që bën shteti ynë fqinj Italia, që u jep plus në pagë paratë e nevojshme për trajnim çdo mësuesi.

Arsimi profesional: Përpara 8 vitesh, ne kundërshtuam kalimin e arsimit Profesional në varësi të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale; sot ka katër vite që është në varësi të Ministrisë së Financave. U premtua se AP do të ishte prioritet i qeverisë, do të rritej numri i nxënësve në arsimin profesional. Jo vetëm numri që nuk është rritur, por ju informojmë se në shkollën profesionale “Stiliano Bandilli” në Berat, këtë vit u mbyll një klasë dhe më e keqja, punësimi i mësuesve në shkollat profesionale i’u la në dorë drejtorëve të shkollave, të cilët nuk respektojnë asnjë lloj kriteri në rekrutimin e mësuesve dhe sot në shkollën e sipërpërmendur janë punësuar si mësues inxhinierë tekstilësh që janë jashtë profilit. Ne e konsiderojmë urgjente atë që kemi përsëritur çdo vit: kaloni Arsimin Profesional në varësi të Ministrisë së Arsimit, ashtu siç e ka gjithë Europa ku rrekemi të shkojmë; mjaft e latë në dorë të inkopentëve të Ministrisë së Financave dhe dyfishoni fondet për arsimin profesional.

Buxheti i parashikuar për arsimin për vitin 2022, nuk përmbush nevojat për arsim cilësor dhe mësimdhënie cilësore. Ne kërkojmë nga ju, të nderuar deputetë, ish – kolegë të mësuesve, të ndikoni fort për rritjen e buxhetit për arsimin, për paga dinjitoze të mësuesve, për kushte pune më të mira, për

klasa e kabinete të pajisura me mjete e teknologji mësimore bashkëkohore, ashtu siç i kanë edhe vendet e rajonit.

Sindikata e punonjësve të Universiteteve të Shqipërisë kërkon:

1. Rritje pagave për pedagogët dhe stafin ndihmës shkencor e administrativ, pasi pa një trajtim me dinjitet të pedagogut, nuk mund të ketë arsim të lartë cilësor.
2. Rritje e pagesës së orëve të ngarkesës suplementare për pedagogët e brendshëm (PAE) dhe pedagogët e jashtëm me kontratë (PAK).
3. Rivlerësim i orës mësimore, pasi ka një zbritje prej 50% të pagesës së orës mësimore, si rezultat i mosdiferencimit të orës mësimore të leksionit, e cila më parë kishte koeficientin 2 për leksionin në Mastër dhe 1.5 për atë në Bachelor, ndërsa tani e ka koeficientin 1, duke u bërë njëlloj me orët e tjera në auditor (seminare, laboratore, praktika, etj.).
4. Rishikim i tatimit prej 23% mbi realizimin e ngarkesës mësimore suplementare si më poshtë:
 - a. Pagesa e orëve suplementare të realizuara gjatë një viti akademik bashkohet me pagën mujore, kur lëvrohet kjo shumë dhe meqenëse bashkë me pagën e atij muaji kalon kufirin përkatës, tatohet 23%. Pagesa e orëve suplementare është shumatore e pagesave mujore që duhet të merreshin të shpërndara gjatë vitit akademik dhe për rrjedhojë tatimi duhej të llogaritej proporcionalisht për çdo muaj të vitit, pra maksimumi me 13%. Me këtë procedurë që është zbatuar gjatë këtyre viteve, janë cenuar padrejtësisht interesat financiare të stafit akademik. Kërkojmë të rishikohet mënyra e përlllogaritjes së tatimit mbi këto të ardhura.
 - b. Pagesa për orët suplementare të mos trajtohet si pagë, por si honorar dhe si e tillë mund të tatohej 15%, si tatim në burim.
5. Rivendosja e shtesave mbi pagë, për “Dëmshtëri shëndeti në punë”, për laborantët dhe stafin akademik që punojnë në laboratore, në kontakte me “substancë të rrezikshme dhe preparate të tjera”.

Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë:

1. Vlerësojmë fillimin e vitit shkollor, duke mbajtur në sistem të gjithë mësuesit e Sistemit Arsimit Parauniversitar.
2. Mbajtja e përqindjes së buxhetit për arsimin në të njëjtin nivel, afërsisht prej 3% të PBB dhe në raport me buxhetin e përgjithshëm prej 7,5% nuk i zgjidh problemet e arsimit, kur janë caktuar objektiva të qarta kombëtare e ndërkombëtare, si në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021 - 2026 dhe nga OKB në Agjendën 2030, ku Shqipëria ishte pjesë e shteteve që e aprovuan.

Duke rritur buxhetin këtë vit të paktën në 3,5% të PBB dhe duke vazhduar çdo vit me një rritje prej 0,5 %, në fund të mandatit të kësaj qeverije arrijmë në 5% të PBB. Duhet të sforcohemi që ta arrijmë këtë. Në të kundërt, do të mbetemi përjetësisht të varfër.
3. Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore. Është bërë e ditur se drejtuesit e institucioneve arsimore në jo pak raste janë pengesë në thellimin e reformave arsimore.
4. Antipatia për profesionin e mësuesit është në rritje. Vendet e BE-së janë alarmuar e po kërkojnë marrjen e masave. Reduktimi i orëve të punës dhe rritja e pagave është në fokusin e masave që po merren. Motivimi i studentëve për të ndjekur fakultetet e mësuesisë është objektiv kryesor.

5. Rritja e pagës me 6% sipas buxhetit dhe rritja e fashos së pagës që nuk tatohet, shërben vetëm si indeksim i pagave, për shkak të inflacionit.

6. Vazhdon të mbetet shqetësimi transporti i mësuesve.

7. Mjetet mësimore janë të pamjaftueshme për mësimdhënie.

8. Ambjente jo të sigurta për mësimdhënie e nxënie.

Shoqata e Botuesve të Teksteve Shkollore

1. Librat e arsimit fillor nga klasa 1-5 propozojmë të falen çdo vit, për shkak se fëmijët janë të vegjël dhe tekstet janë konceptuar me ushtrime, ku edhe shkruhet mbi to. Ndërsa klasat 6-9 të falen në çdo 2 vjet.

2. Kur të bëhet indeksimi i çmimeve të teksteve shkollore, duhet mbajtur parasysh që letra është produkt burse dhe çmimi i saj është rritur 50-60%.

3. Është e nevojshme të ketë rritje të fondit për pasurimin e bibliotekave të shkollave.

4. Në ciklin parashkollor ka mungesë të theksuar të mjeteve e lodrave didaktike, të botimeve mësimore dhe të atyre artistike, në një kohë kur në tregun e librit ka botime dhe mjete didaktike mjaft cilësore.

5. T'i kushtohet një vëmendje më e veçantë në buxhet procesit të digjitalizimit, tabelave digjitale për çdo klasë, internetit në çdo shkollë. Ka nisur digjitalizimi i teksteve në ciklin e mesëm dhe është shumë e rëndësishme të shtrihet në të gjithë ciklin parauniversitar. Ne, si botues, kemi bërë investimet tona në këtë drejtim duke ecur paralel me politikën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Qendra Për Arsim Cilësor

- Ajo që ne vëmë re dhe për këtë projektbuxhet, vijon të mbetet një zhgënjim serioziteti me të cilin shihet investimi për arsimin. Në relacion, pa dashur fare të merremi me analizën e buxhetit, ajo që ne shohim vijnë të mbeten po të njëjtat priorite, prej vitesh tashmë, pothuaj i njëjti buxhet, madje me një përqindje ndaj GDP më të ulët se buxheti i vitit të mëparshëm. Krahasuar me vitin e mëparshëm, fondet e miratuara për tavanët përfundimtarë të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 sipas artikujve buxhetore, ajo që vihet re është rënie e % e GDP nga njëri vit tek tjetri.
- Përkundër faktit që buxheti në përgjithësi siguron një rimëkëmbje të ekonomisë, kjo nuk reflektohet në buxhetin që alokohet për arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve tanë. Ne % ndaj GDP 2.55% 2.51% 2.38% 2.27%, vëmë re ulje të buxhetit nga viti 2022 deri në vitin 2024.
- Ministria e Arsimit vijon të flasë për rritje investimesh, por ndërkohë në këtë buxhet nuk shohim investimin për rritjen e sigurisë në shkolla, si një prioritet të kësaj ministrie. Për shkak të mosangazhimit serioz të Ministrisë së Arsimit, ajo që ne me keqardhje vëmë re është dështimi në rritjen e sigurisë në shkolla dhe kjo për shkak të moshartimit të planeve konkrete për shkolla të sigurta dhe mbetjes në arsimin e planeve që janë hartuar vite e vite më parë.
- Relacioni i buxhetit ndalet dhe tek ofrimi i bursave financiare apo kuotë ushqimore/financiare për nxënësit me nevoja të veçanta, si dhe fëmijëve me ndikim uljen e braktisjes shkollore, nxënësve të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevoje, por ajo që ne vëmë re është se nuk ka një shifër rreth numrit të fëmijëve, për të cilin MAS dedikon buxhet për këtë kategori. Duam t'ju bëjmë me dije se edhe për shkak të kushteve specifike që janë të nevojshme për transportin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, *nuk ka transport për fëmijët me AK; ata rregjistrohen në shkolla, por nuk e vijnë atë.*

- *Nuk ka buxhet të dedikuar për bazën materiale për fëmijët me Aftësi të Kufizuara.*

Qendra T'REJA, Qendra për Advokim Social, Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome, Drejtësi Sociale, Qendra për Organizim dhe Fuqizim Komunitar dhe Qendra Aksion Komunitar janë organizata të cilat në fokus të veprimtarisë së tyre, ndër të tjera, kanë mbështetjen e familjeve në nevojë, kryesisht ato romë dhe egjiptiane, për garantimin e aksesit në arsimin parauniversitar të fëmijëve të këtyre dy minoriteteve. Në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022 kemi kërkuar të jemi pjesë e proceseve konsultuese në diskutimin me palët e interesit në Komisionin për Edukimin dhe Median për të shprehur sugjerimet tona lidhur me buxhetin e parashikuar për ofrimin e mbështetjes financiar për kategorinë e fëmijëve në rrezik për braktisjen e shkollës. Siç mund të jeni në dijeni, fëmijët e minoriteteve rom dhe egjiptian të familjeve në nevojë janë në risk të vazhdueshëm për braktisjen e shkollës, si pasojë e situatës social-ekonomike në të cilat gjenden familjet e tyre. Jemi në dijeni të Vendimit nr. 666, dt.10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte dhe përcaktimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”. Ajo çka vihet re është fakti që tek ky vendim, nxënësit romë dhe egjiptianë nuk janë përfitues si kategori e veçantë, ashtu si disa kategori të tjera. Për këtë arsye edhe në planin buxhetor të vitit 2022-2024 kuotat e përcaktuara për përfitimin e bursave, nuk i përcakton si përfitues, duke marrë parasysh kriterin e përkatësisë etnike.

IV. QËNDRIMI I OPOZITËS

Gjatë gjithë takimeve, deputetët e opozitës vërejtën rastet e shmangies së prioriteteve të caktuara nga plani për arsimin dhe kulturën dhe sugjeruan ndryshime përmirësuese, duke shprehur se në tërësinë e tij Projektbuxheti 2022 për Arsimin dhe Kulturën nuk reflekton nevojat konkrete kombëtare dhe nuk reflekton përmirësime në problemet e mbartura; nuk pasqyron nevojat gjithëpërfshirëse dhe nuk jep hollësitë për probleme të caktuara që kanë qenë edhe debate publike. Ata sugjerojnë që Ministrinë e linjës t'i kenë në konsideratë vërejtjet e tyre konstruktive në draftin përfundimtar të Buxhetit 2022, sa kohë ato janë për përmirësimin e punës së institucioneve, si edhe për përmirësimin e jetës së shqiptarëve. Deputetët e opozitës dhanë mbështetjen e tyre për fondet shtesë në buxhetet e disa institucioneve të pavarura arsimore e kulturore, për përmirësimin e performancës së tyre. Z.Agron Gjekmarkaj shprehet se vota kundër e opozitës shkon pasi ky pojektligj nuk përputhet me nevojat e arsimit.

V. DISKUTIMI NË KOMISION

Në diskutimin në parim për projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022”, gjatë seancave me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera, u fol gjerësisht për projektligjin dhe u diskutua, në mes të tjerash, për kushtet kur diskutohet ky buxhet, qëndrueshmërinë e tij, përmbushjen e Programit të Qeverisë Shqiptare, prioritetet e saj, ku arsimit, kultura, shkenca e sporti kanë vëmendje të veçantë, gjë që shprehet, në mes të tjerash, në rritjen e buxhetit në disa drejtime. Në mbështetje të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022”, u shpreh deputeti Petro Koçi, si dhe deputetë të tjerë të mazhorancës, ndërsa ishin kundër projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2022” deputetët e opozitës.

VI - PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2022” në tërë komponentët e tij, me votat e shumicës së deputetëve të pranishëm, miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2022" dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Lindita Buxheli

Iir Topi

Flutura Aça

Luçiano Boçi

KRYETAR

Agron Gjekmarkaj